



SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS
SINDIKAT KOSOVSKE POLICIJE
KOSOVO POLICE UNION

ORGANIZIMI SINDIKAL STRUKTURA LIGJORE

[Manual Informues]

Parathënie

I/e nderuar

Në kuadër të projektit “Ngritja e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve të punonjësve të Policisë”, i cili financohet nga "Olof Palme International Center" me mbështetjen e Qeverisë së Suedisë, ky manual iu dedikohet anëtarëve të Sindikatës të Policisë së Kosovës (SPK), të cilët do të përfshihen në aktivitetet e organizuara të SPK-së gjatë vitit 2019, përkatësisht sesioneve informuese, tryezave dhe konferencës.

Manuali përmban informacione për Sindikatën e Policisë, organizimin, infrastrukturën normative, aktivitetet dhe strukturën ligjore.

Në këto aktivitete në kuadër të këtij projekti do të përfshihen më shumë se 250 persona.

Përmbajtja

Parathënie	1
Përmbajtja	2
Lista e shkurtesave:	3
Përmbledhje	4
Aktet Normative:	6
Kriteret unike.....	7
Lojërat sportive	7
Konferenca rajonale e seksioneve të femrave të sindikatave të policisë	7
Objektivat	9
Sigurimi Shëndetësor	9
Resurset.....	10
Të drejtat dhe kufizimet e personelit policor sipas Ligjit të Policisë	10
Ligji nr. 04/l-161 - për sigurinë dhe shëndetin në punë	11
Ligji nr. 03/l-212 - i punës.....	15
Ligji 06/l-111 për pagat në sektorin publik.....	15
Ligji nr. 05/l -020 - për barazi gjinore	17
Ligji nr. 04/l-008 për këshillin ekonomik-social.....	19

Lista e shkurtesave:

- **SPK** – Sindikata e Policisë së Kosovës;
- **QPA** - Qendra për Politika dhe Avokim;
- **PEN** - Peer Educators Network (Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë);
- **I punësuari** - Personi fizik i punësuar për të kryer punë ose shërbime me pagesë për punëdhënësin;
- **Punëdhënësi** - Personi fizik ose juridik i cili i siguron punë të punësuarit dhe i paguan pagën për punën ose për shërbimet e kryera;
- **Këshilli Ekonomik-Social (KES)** - Organi i nivelit nacional i cili udhëheq konsultimet për çështjet nga marrëdhënia e punës, mirëqenia sociale dhe çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me politikat ekonomike në Republikën e Kosovës;
- **Kontrata Kolektive** - Marrëveshja ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave të të punësuarve me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas marrëveshjes së arritur;
- **Marrëdhënia e Punës** - Një marrëveshje ose rregullim kontraktual ndërmjet një punëdhënësi dhe të punësuarit për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësiive specifike nga i punësuarit nën mbikëqyrjen e punëdhënësit, kundrejt një pagese të dakorduar, zakonisht në formë të parave;
- **Paga** - Shpërblimi ose fitimi i çfarëdo niveli të llogaritur e shprehur në para për të punësuarin;
- **Paga minimale** - Paga minimale e propozuar nga KES-i ndërsa e vendosur nga Qeveria, sipas kriterëve të përcaktuara me këtë në pajtim me këtë ligj;
- **Diskriminimi** - Çdo dallim që përfshin përjashtim ose dhënie të përparësisë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, moshës, gjendjes familjare, mendimit politik, prejardhjes kombëtare ose sociale, gjuhës ose anëtarësisë sindikale, që e ka fuqinë e anulimit ose mosdhënies së mundësive të barabarta për punësim apo profesion apo ngritje profesionale.

Përmbledhje

Organizata sindikale e Policisë së Kosovës është konstituuar më 8 korrik 2005, kur edhe është mbajtur Kuvendi i Përgjithshëm Zgjedhor. Përbëhet nga 9 Shoqata Rajonale: DPP, Policia Kufitare, Prishtina, Prizreni, Peja, Gjilani, Mitrovica Jugu, Gjakova dhe Ferizaj.




Figura 1: Skema organizative e SPK-së

Në kuadër të shoqatave janë të organizuara njësitet sindikale, pra nëpër njësi, përkatësisht në stacione policore. Zgjedhjet në të gjitha nivelet janë kryer me vota të fshehta dhe me më shumë kandidatë. Struktura nacionale dhe gjinore reflekton strukturën e të punësuarve në Policinë e Kosovës.

Organet drejtuese të sindikatës janë: Këshilli Drejtues dhe Kryesia Ekzekutive e Sindikatës të Policisë së Kosovës.

Memorandumi i firmosur ndërmjet Sindikatës të Policisë së Kosovës dhe Komisarit të atëhershëm të Policisë së Kosovës ka vendosur kushtet për funksionimin e Sindikatës të Policisë së Kosovës.

Mbështetur në Memorandumin e Mirëkuptimit, sindikata merr pjesë në shumicën e bordeve/komisioneve brenda Policisë së Kosovës (sipas Memorandumit është obligative pjesëmarrja e SPK-së në të gjitha bordet).

Viteve të fundit, organet drejtuese të Sindikatës të Policisë së Kosovës janë angazhuar në pjesëmarrjen aktive, duke dhënë kontributin e tyre në hartimin e pakove ligjore, përkatësisht projekt-ligjeve:

Projekt-ligjit për paga;

Projekt-ligjit për zyrtarët publikë;

Projekt-ligjit për riorganizimin e administratës shtetërore;

Projekt-ligjit për pensionimin e zyrtarëve policorë etj.

Komisioni i përbashkët i punës për Projekt-ligjin për paga, pas një pune gati dyvjeçare, hartoi propozimet përkitazi me koeficientet e pagave për punonjësit e Policisë në dokumentin përmbledhës të titulluar “Komentet e Policisë përkitazi me Ligjin e pagave” (nivelimin e pagave) dhe me kohë i dorëzoi Qeverisë së Republikës së Kosovës për procedurë të mëtejme.

Në propozimet e bëra janë përshkruar **specifikat që** e dallojnë Policinë e Kosovës me agjencitë e tjera dhe shërbimin civil. Qysh me datë 11 shkurt 2017 janë dhënë komentet në koncept-dokumentin për Ligjin e shërbyesve civilë, me **arsyetimet pse struktura civile e punësuar në Policinë e Kosovës duhet të përjashtohet nga ky ligj**. Arsyetimi është mbështetur në faktin se Ligji i Policisë ka paraparë rregullime ndryshe për strukturën civile në Policinë e Kosovës, që e dallojnë nga shërbyesit civilë. Si personeli policor - zyrtarët policorë, ashtu edhe personeli policor - stafi civil duhet të përjashtohen nga Ligji për shërbimin civil për shkak të specifikave të veçanta dhe kushtet nën të cilat kryejnë detyrat, që janë shumë specifike.

Po ashtu, drejtuesit e Sindikatës të Policisë së Kosovës gjatë gjithë vitit të kaluar u angazhuan në mënyrë aktive në hartimin dhe përfundimin e Projekt-ligjit për pensionimin e zyrtarëve policorë. Versioni final i këtij projekt-ligji përmban propozimet e Sindikatës të Policisë së Kosovës, por mbetet që gjatë këtij viti deri në aprovimin e tij t'i kushtohet vëmendje dhe një përkushtim serioz nga ana e sindikatës, në mënyrë që ligji final të jetë sa më i dinjitetshëm.




Figura 2: Anëtarësia e SPK-së sipas Rajoneve Policore

Aktet Normative:

Sindikata e Policisë së Kosovës aktivitetet e veta i zhvillon në harmoni me aktet normative të sindikatës, mbështetur në Statutin, Rregulloret, Kriteret Unike për ofrimin e ndihmave financiare, e të tjera.

Anëtarët e SPK-së, konform statutit dhe kriterëve unike, kanë të drejtë të marrin pjesë në krijimin dhe zbatimin e politikës sindikale, të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e Sindikatës, në ndihmë juridike dhe në realizimin e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të cilat lidhen me punën dhe marrëdhënien e punës, në informim, arsimim dhe aftësim të organizuar nga Sindikata, në ndihmë materiale nga fondet e Sindikatës, në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave që parasheh Kontrata Kolektive lidhur me pagat, kushtet e punës dhe elementet e tjera të Kontratës Kolektive, në ndihmën dhe përfaqësimin e sindikatës në procedurë disiplinore të ngritur kundër anëtarit të Sindikatës, në forma dhe mënyra tjera të realizimit dhe të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave në bazë të anëtarësimit në Sindikatë.

Në mungesë të sigurimeve shëndetësore, organet drejtuese, përkatësisht Këshilli Drejtues i Sindikatës të Policisë së Kosovës, mbështetur në aktet normative të SPK-së që nga fillimi ka aprovuar dhe zbaton:

Kriteret unike

në rastet e ofrimit të ndihmës financiare anëtarit të SPK-së

Në bazë të së drejtës të anëtarit të SPK-së për të aplikuar për ndihmë financiare tre muaj pas anëtarësimit në SPK, përkatësisht pas pagesës së anëtarësisë për tre muaj, sindikata, organet drejtuese të shoqatave rajonale dhe ato qendrore, ndihmojnë anëtarët e SPK-së në rastet e shërimit, operimit, në rastet e vdekjes të anëtarit të ngushtë të familjes, në rastet e vdekjes të anëtarit të SPK-së, trajtim i nevojshëm terapeutik në banja etj.

Lojërat sportive

Sindikata e Policisë së Kosovës, në shenjë respekti dhe përkujtimi për zyrtarët policorë të rënë në detyrë, organizon Lojërat Tradicionale Sportive. Kësisoj, vitin e kaluar u organizua dhe u mbajt Edicioni i VI-të i lojërave sportive në Pejë.



Figura 3: Lojërat Sportive 2018

Konferenca rajonale e seksioneve të femrave të sindikatave të policisë

Mbështetur nga "Olof Palme International Center" dhe "Friedrich Ebert Stiftung" - Zyra në Kosovë, Sindikata e Policisë së Kosovës, përkatësisht Rrjeti i Femrave i kësaj sindikate, më 20 tetor 2018 organizoi dhe mbajti konferencën rajonale të rrjeteve të femrave të sindikatave të Policisë.

Tema të konferencës ishin:

“Të drejtat dhe pozita e femrave të punësuara në polici dhe mbrojtja e të drejtave të tyre në punë” dhe “Bashkëpunimi rajonal në fuqizimin e rrjeteve të femrave të sindikatave të policisë”.

Në konferencë morën pjesë delegacionet e rrjeteve të grave të sindikatave të Policisë nga Kroacia, Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia, konfederata sindikale e BSPK-së dhe federatat sindikale vendore. Në fund të punës së konferencës unanimisht u mbështetën:



Figura 4. Konferenca rajonale e seksioneve të femrave të sindikatave të policisë

Konkluzat e konferencës

1. Fillimi i sigurimeve shëndetësore dhe jetësore që nga janari i vitit 2019;
2. Hapja e zyrës së avokaturës në kuadër të Policisë së Kosovës;
3. Zbatimi në tërësi i Kontratës së Përgjithshme Kolektive;
4. Hartimi dhe implementimi i Kontratës Kolektive Sektoriale;
5. Angazhimi i drejtuesve të SPK-së në debatin rreth ndryshimeve në Ligjin e punës, me theks të veçantë në rregullimin sa më të dinjitetshëm të pushimit të lehonisë dhe çështjeve të tjera;

6. Vazhdimi dhe intensifikimi i mëtejme i bashkëpunimit rajonal, si dhe diskutimi rreth propozim/nismës për diskutim të mëtejme rreth themelimit të një asociacioni të Evropës Juglindore.

Objektivat

- **Sigurimi Shëndetësor;**
- Ngritja e pozitës materiale të të punësuarve;
- Hartimi dhe nënshkrimi i Kontratës Kolektive Sektoriale;
- Definimi i statusit të strukturës civile të punësuar në Policinë e Kosovës;
- Aftësimi profesional i anëtarësisë përmes trajnimeve, seminareve dhe konferencave;
- Krijimi i kushteve për veprim profesional të sindikatës, veçmas në mbrojtjen e të drejtave të anëtarësisë, (**hapja e zyrës së avokaturës në Policinë e Kosovës**);
- Organizimi dhe fuqizimi i Rrjetit Rinor dhe Rrjetit të Grave në kuadër të Sindikatës të PK-së.

Sigurimi Shëndetësor

Gjate vitit 2018, sindikata e PK-së i është drejtuar me kërkesa zyrtare kryeministrit të Qeverisë së Kosovës, ministrit të Financave, ministrit të Punëve të Brendshme dhe drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës në lidhje me sigurimin shëndetësor dhe aksidental alternativ, kërkesë kjo e cila deri më tani nuk ka hasur në mirëkuptim edhe pas shumë presioneve.



Figura 5: Takimi i Sindikatës të Policisë së Kosovës së bashku me stafin e lartë menaxherial të Policisë së Kosovës

Drejtuesit e Sindikatës të Policisë së Kosovës, së bashku me stafin e lartë menaxherial të Policisë së Kosovës dhe përfaqësuesin e MPB-së, më 18 janar 2018 në objektin e PK-së u takuan me përfaqësuesit e Shoqatës të Sigurimeve të Kosovës dhe përfaqësuesit e kompanive të sigurimeve. Në këtë takim u diskutua përkitazi me mundësinë e sigurimit shëndetësor dhe jetësor për punonjësit e Policisë së Kosovës. U dakorduan që në javët në vijim të dalin me propozime konkrete për këtë çështje jetike për punonjësit e PK-së.

Resurset

Realizimin e objektivave në vazhdim e shohim përmes:

- Aktiviteteve në vazhdimësi të SPK-së;
- Projekteve të ndryshme nga partnerët tanë, siç është "Olof Palme Internacional Center";
- Bashkëpunimit dhe aktiviteteve të përbashkëta me partnerët tanë PEN - Peer Educators Network (Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë) dhe QPA (Qendra për Politika dhe Avokim);
- Dialogut dhe presioneve mediale.

Të drejtat dhe kufizimet e personelit policor sipas Ligjit të Policisë

Të drejtat dhe kufizimet e personelit policor

Neni 46

1. Personeli policor gëzon të drejta të njëjta civile dhe politike, sikurse të gjithë qytetarët e tjerë, duke iu nënshtruar vetëm kufizimeve në këtë ligj që janë të nevojshme për ushtrimin efektiv të autorizimeve dhe detyrave policore në shoqërinë demokratike.

2. Personeli policor gëzon të drejta të njëjta sociale dhe ekonomike sikurse shërbyesit e tjerë publikë, siç janë e drejta për të organizuar apo për të marrë pjesë në organizata përfaqësuese dhe t'i pranojnë shpërblimet e duhura, sigurimin social, ndihmën juridike, benificione shëndetësore dhe benificionet të tjera për punën e tyre.

3. Personeli policor nuk ka të drejtë të bëjë grevë, por ka të drejtë t'i shprehë pakënaqësitë e tij nëpërmjet protestave të organizuara dhe të udhëhequra nga organet përfaqësuese.



Figura 6: Ligji për Policinë e Kosovës

Paga dhe kompensimi për personelin policor

Neni 47

1. Kompensimi për zyrtarët policorë ka parasysh kushtet e veçanta nën të cilat ata i kryejnë detyrat e tyre. Paga themelore e zyrtarëve policorë ndryshon, duke u bazuar në faktorët përfshirës, por jo të kufizohet vetëm me gradën dhe kohëzgjatjen e shërbimit.

2. Si shtesë e pagës themelore, zyrtarët policorë në mënyrë të ligjshme marrin lloje të shtesave, kompensime dhe beneficione. Pagesat e tilla shtesë bazohen në faktorët duke përfshirë, por jo të kufizohen vetëm në detyrat e rrezikshme, punën nën stres, punën jashtë orarit, orarin e punës me ndërrime, punën gjatë festave ose ditëve të tjera që janë ditë pushimi, caktimin në punë të veçanta dhe për shkathtësi të veçanta.
3. Shtesat përfshijnë, por nuk kufizohen në kompensime për punë të rrezikshme, punën nën stres, kompensime për orar të punës me ndërrime, pagesa gjatë festave, pagesa për punë jashtë orarit, dhe pagesa për caktim në punë të veçantë. Beneficionet mund të përfshijnë, por jo të kufizohen në, shpenzimet mjekësore dhe shëndetësore, shpenzimet për trajnimet profesionale dhe teknike, shpenzimet jetësore për transferim të përkohshëm, pushim me pagesë, kompensimet në rastet e vdekjes, dhe beneficionet e pensionit.
4. Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj.
5. Përveç pensionit invalidor që e gëzojnë në bazë të ligjit në fuqi, zyrtarët policorë të cilët bëhen invalidë në kryerje të detyrës apo në detyrë kanë të drejtë në pension invalidor 20% të pagës bruto.

Ligji nr. 04/I-161 - për sigurinë dhe shëndetin në punë

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i masave për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë.
2. Ky ligj përmban parimet e përgjithshme për parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve të rrezikut dhe aksidenteve, informimit, konsultimit, pjesëmarrjes së balancuar në përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, trajnimin të të punësuarve, përfaqësuesve të tyre dhe udhëzimeve të përgjithshme për zbatimin e këtyre parimeve.

Neni 5

Parimet e përgjithshme për punëdhënësin

1. Punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurt dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës.

2. Punëdhënësi është i detyruar që të mbulojë të gjitha shpenzimet për kurimin e të punësuarit që ka pësuar lëndim në punë apo sëmundje profesionale, nëse nuk i ka siguruar në ndonjë kompani të sigurimeve të të punësuarit në pikëpamje shëndetësore.
3. Punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e hollësishëm mbi rreziqet për secilën vend të punës.
4. Punëdhënësi është i detyruar të udhëhiqet nga parimi i trajtimit të barabartë në marrjen e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë të punësuarit.

Neni 6

Detyrimet e përgjithshme të punëdhënësit

1. Në kuadër të përgjegjësive të tij, punëdhënësi detyrohet të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, sigurimin e informatave, trajnimeve të të punësuarve për punë të sigurt, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës, masat për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës.
2. Punëdhënësi duhet të veprojë në vazhdimësi në përmirësimin e kushteve të punës për të ngritur nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke i ndryshuar dhe plotësuar masat e ndërmarra më parë, varësisht prej rrethanave të cilat krijohen me ndryshimet e proceseve teknike - teknologjike.
3. Punëdhënësi i përgjigjet të punësuarit për dëmet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjet profesionale ose sëmundjet e lidhura me punën, sipas parimit të përgjegjësive objektive të së drejtës së detyrimeve.

Neni 8

Bashkëpunimi i punëdhënësve në zbatimin e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë

1. Punëdhënësit të cilët shfrytëzojnë të njëjtën zonë (hapësirë, lokale, rrugë, etj.) të punës, janë të detyruar që të bashkëpunojnë në zbatimin e masave që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, duke marrë parasysh natyrën e aktiviteteve të subjekteve punuese.
2. Punëdhënësit duhet të koordinojnë aktivitetet e tyre për të krijuar kushte të sigurta dhe të shëndetshme në punë, dhe t'i informojnë të punësuarit ose përfaqësuesit e tyre për rreziqet në punë.
3. Masat e sigurisë dhe shëndeti në punë, nën asnjë rrethanë, nuk mund të bien në ngarkesë financiare të të punësuarve.
4. Punëdhënësi në cilësinë e investitorit, do të lidhë marrëveshje kontraktuale në formë të shkruar, me personat të cilët kryejnë veprimtari pune për të, përkatësisht me kontraktuesit dhe nënkontraktuesit, në të cilën marrëveshje përcaktohet përgjegjësia për sigurinë dhe shëndetin në punë.

5. Nëse nuk arrihet marrëveshje kontraktuale në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, përgjegjësia për sigurinë dhe shëndetin në punë, sipas këtij ligji, bie mbi investitorin.

Neni 9

Shërbimet për mbrojtjen dhe parandalimin

1. Çdo punëdhënës është i detyruar të ngarkojë një ose më shumë të punësuar, për të kryer aktivitete nga siguria dhe shëndeti në punë, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me këtë ligj.
2. I punësuar i ngarkuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk mund të cenohet për shkak të aktiviteteve të tij në lidhje me mbrojtjen dhe parandalimin e rrezeve në punë, as nga punëdhënësi, as nga të punësuarit e tjerë.
3. Për të punësuarin e ngarkuar, i cili ushtron aktivitetet nga siguria dhe shëndeti në punë, punëdhënësi duhet të sigurojë trajnime dhe mjete të nevojshme për punë.
4. Punëdhënësi, në mungesë të personelit të kualifikuar për të udhëhequr sigurinë dhe shëndetin në punë, brenda subjektit të tij do të angazhojë persona ose institucione për shërbime profesionale të jashtme.
5. Ministria, me akt nënligjor, varësisht prej llojit të veprimtarisë, përcakton kushtet dhe kriteret, për certifikimin dhe licencimin e personave dhe institucioneve për shërbime nga paragrafi 4 i këtij neni.
6. Personat e jashtëm apo institucionet për të ushtruar aktivitetet nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë duhet të jenë të pajisura me mjetet dhe pajisjet e duhura profesionale të punës si dhe aparaturat matëse adekuate.
7. Në rastet kur punëdhënësi angazhon persona apo institucion për shërbime në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë, është i detyruar t'i informojë dhe njoftojë ata me procesin e punës, me rreziqet e mundshme, me rrethanat të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë në sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve dhe me masat parandaluese që i ka ndërmarrë për të krijuar kushte të sigurt dhe të shëndetshme të punës për të punësuarit.

Neni 10

Të punësuarit e ngarkuar për siguri dhe shëndet në punë

1. Punëdhënësi i cili punëson deri në pesëdhjetë (50) të punësuar, nëse është i aftë/kompetent, mund të marrë vetë përgjegjësinë për zbatimin e masave të përcaktuara në paragrafin 1, të nenit 9, të këtij ligji, me kusht që t'i plotësojë kushtet dhe kriteret sipas paragrafit 5, të nenit 9, të këtij ligji.
2. Punëdhënësi i cili punëson mbi pesëdhjetë (50) e më pak se dyqindpesëdhjetë (250) të punësuar, është i detyruar të caktojë një ekspert, për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë.
3. Punëdhënësi i cili punëson më shumë se dyqind e pesëdhjetë (250) të punësuar duhet të

angazhojë një (1) ose më shumë ekspertë për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë.

Neni 17

Punët me kushte të veçanta

1. Punë me kushte të veçanta sipas dispozitave të këtij ligji, janë punët që mund të kryhen vetëm nga të punësuarit të cilët përveç kushteve të përgjithshme për themelimin e marrëdhënies së punës, duhet të përmbushin edhe kushtet dhe kriteret e veçanta të moshës, gjinisë, aftësisë profesionale, shëndetësore, fizike, gjendjes mendore, psiko-fizike dhe psikologjike.
2. Punëdhënësi nuk duhet të caktojë të punësuarin në punë me kushte të veçanta, në qoftë se paraprakisht, në mënyrë të shkruar, nuk është përcaktuar që i punësuar i plotëson kushtet dhe kriteret e nevojshme nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Punëdhënësi është i detyruar që para së ta caktojë të punësuarin në vend të punës me kushte të veçanta, ta dërgojë atë në kontroll mjekësor, që të konstatojë aftësitë e tij shëndetësore, fizike dhe psikike, për kryerjen e punëve në atë vend të punës.
4. Punëdhënësi është i detyruar të ofrojë dëshmi me shkrim në përshkrimin e punëve dhe detyrave të punës për të punësuarin në vend të punës me kushte të veçanta, se ai i plotëson kushtet dhe kriteret për punë në vend të punës me kushte të veçanta në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni.
5. Punëdhënësi të punësuarin i cili punon në vend të punës me kushte të veçanta të punës, është i detyruar ta dërgojë në kontrollim mjekësorë së paku një herë në vit dhe sa herë të paraqitet nevoja, varësisht prej gjendjes shëndetësore të tij.

Kontrollimet mjekësore të të punësuarve

Neni 22

Kontrollimet mjekësore

1. Punëdhënësi është i detyruar t'iu sigurojë të punësuarve kontrollime mjekësore në institucionet shëndetësore të licencuara për shërbime nga mjekësia e punës në pajtim me paragrafin 5, të nenit 17, të këtij ligji.
2. Punëdhënësi është i detyruar t'i dërgojë në kontrollim mjekësor të gjithë të punësuarit së paku një herë në tre (3) vjet.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji nr. 03/l-212 - i punës

Dispozitat themelore

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, siç përcaktohen me këtë ligj.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës.
2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës.
3. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit me shtetësi të huaj dhe personat pa shtetësi, të cilët janë të punësuar tek punëdhënësit në territorin e Republikës së Kosovës, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.
4. Dispozitat e këtij ligji nuk janë të aplikueshme për marrëdhëniet e punësimit brenda misioneve ndërkombëtare, misioneve diplomatike dhe konsullore të shteteve të huaja, Pranisë Ushtarake Ndërkombëtare të vendosur në Republikën e Kosovës në bazë të Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin dhe organizatat ndërkombëtare qeveritare.

Ligji 06/l-111 për pagat në sektorin publik

Neni 14

Shtesa të posaçme për zyrtarët policorë

1. Zyrtarët policorë përfitojnë një shtesë të posaçme për ato detyra që kryejnë në sektorë apo operacione të posaçme me rrezikshmëri për jetën.
2. Shtesa e posaçme, sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk mund të jetë më e lartë se **40% e pagës** bazë, sipas Shtojcës.
3. Lista e pozitave të zyrtarëve policorë, që përfitojnë shtesën e posaçme, rregullat për fitimin dhe vlera e shtesës përcaktohet me akt nënligjor të Qeverisë, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punë të brendshme dhe ministrisë përgjegjëse për financa.

Neni 23

Përcaktimi i vlerës së koeficientit dhe fondi për shtesa

1. Vlera monetare e koeficientit për vitin e parë të zbatimit të këtij ligji do të jetë dyqind e tridhjetë e nëntë (239) euro.
2. Për vitet e tjera buxhetore, vlera monetare e koeficientit përcaktohet me ligjin vjetor të buxhetit.
3. Përcaktimi i vlerës së koeficientit bëhet në pajtim me legjislacionin për menaxhimin e financave publike.
4. Fondi i përgjithshëm për të gjitha shtesat sipas këtij ligji nuk mund të kalojë tetë për qind (8%) të buxhetit të përgjithshëm të pagës bazë të përcaktuar sipas ligjit për ndarjet buxhetore.
5. Fondi sipas paragrafit 4. të këtij neni alokohet nga Ministria e Financave, përgjegjëse për organizatat buxhetore vetëm në pajtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji.

Koeficientet e pagave në PK sipas Ligjit të Pagave:

Titulli i pozitës	Klasa	Koeficienti
1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë	A4	8
2. Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Policisë	P1	6.5
3. Ndihmësdrejtor/ Drejtor i Departamentit në Policisë	P2	6
4. Kolonel në PK	P3	5
5. Nënkolonel në PK	P4	4.55
6. Major në PK	P5	3.9
7. Kapiten në PK	P6	3
8. Toger në PK	P7	2.75
9. Rreshter në PK	P8	2.4
10. Polic i Lartë në PK	P9	2.2
11. Polic	P10	2
12. Polic i ri	P11	1.9
13. Kadet policor	P12	1

Ligji nr. 05/1 -020 - për barazi gjinore

Neni 1

Qëllimi

1. Ky ligj garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.
2. Ky ligj përcakton masat e përgjithshme dhe të veçanta për mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të barabarta të femrave dhe meshkujve, si dhe përcakton institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre.
3. Ky ligj është në përputhshmëri me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Femrës (CEDAW); Direktivën për krijimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion (Direktiva 2000/78/EC; Direktivën për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtim të barabartë të meshkujve dhe femrave në çështjet e punësimit dhe profesionit (Direktiva 2006/54/EC); Direktivën në zbatimin progresiv të parimit të trajtimit të barabartë të meshkujve dhe femrave në çështjet e sigurimit shoqëror (Direktiva e Këshillit, datë 19 dhjetorit 1978 (79/7/EEC); Direktivën mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis meshkujve dhe femrave të angazhuar në një aktivitet në një kapacitet të vetë-punësuar dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 86/613 / EEC (Direktiva 2010/41 EU, datë 7 korrik 2010); Direktivën për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis meshkujve dhe femrave në qasje dhe furnizim me mallra dhe shërbime (Direktiva 2004/113/EC).

Neni 2

Fushëveprimi

1. Ky ligj vlen për meshkujt, femrat dhe personat që kanë një karakteristikë të mbrojtur të identitetit gjinor apo të seksit, si dhe garanton mundësi dhe trajtim të barabartë, në sferën publike dhe private të jetës shoqërore, duke përfshirë jetën politike dhe publike, punësimin, arsimin, shëndetësinë, ekonominë, përfitimet shoqërore, sportin, kulturën dhe sferat tjera të përcaktuara me këtë ose ndonjë ligj tjetër.

Neni 4

Ndalimi i diskriminimit gjinor

1. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë gjinor, duke përfshirë trajtimin më pak të favorshëm të femrave për shkak të shtatzënisë dhe amësisë, gjendjes martesore, kombësisë, racës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, statusit social, besimit fetar dhe besimit, moshës, ose ndonjë bazë tjetër të përcaktuar me ligj apo marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare në fuqi.

2. Dhuna në baza gjinore është një formë e diskriminimit e cila seriozisht pengon aftësinë e femrave dhe meshkujve që t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë në baza të barabarta dhe është e ndaluar.
3. Ngacmimi dhe ngacmimi seksual janë të ndaluara. Refuzimi apo dorëzimi i një personi ndaj sjelljes së tillë nuk mund të përdoret si bazë për një vendim që prek atë person.
4. Me qëllim të ndalimit të diskriminimit gjinor me legjislacion, politika, programe dhe praktika, parimi i barazisë gjinore dhe integritet gjinor, duke përfshirë përfitimet pas shtatzënisë dhe lindjes, zbatohet në të gjitha planifikimet, buxhetimet dhe zbatimet e akteve të mësipërme nga subjektet publike dhe private.
5. Udhëzimi për diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të gjinisë konsiderohet diskriminim sipas kuptimit të këtij ligji.
6. Nuk do të ketë viktimizim të personave të përfshirë në parashtrimin apo procedimin e ankesave të diskriminimit, ngacmimit apo ngacmimit seksual të parashtruara në bazë të këtij ligji.

Neni 5

Masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë Gjinore

1. Me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor si dhe arritjes së barazisë gjinore, institucionet e Republikës së Kosovës të të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet e tjera publike janë përgjegjëse për të zbatuar masat legjislative dhe masat tjera duke përfshirë:
 - 1.1. analizën e statusit të femrave dhe meshkujve në organizatat dhe fushat përkatëse;
 - 1.2. miratimin e strategjive dhe planeve të veprimit për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore në përputhje me Programin e Kosovës për barazi gjinore;
 - 1.3. përfshirjen e integritet gjinor në të gjitha politikat, dokumentet dhe legjislacion;
 - 1.4. sigurimin e proceseve të përzgjedhjes, punësimit dhe caktimit në punë, duke përfshirë edhe pozicione drejtuese, në përputhje me kërkesën për përfaqësim të barabartë të femrave dhe meshkujve;
 - 1.5. përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve;
 - 1.6. sigurimin e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve në të gjitha konferencat, mbledhjet, seminarët dhe trajnimet jashtë dhe brenda vendit;
 - 1.7. caktimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare për programe, projekte, dhe iniciativa për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e femrave;
 - 1.8. ndarjen sipas gjinisë të të gjitha të dhënave të nevojshme statistikore, që mbliidhen, regjistrohen, përpunohen dhe obligohen që këto të dhëna t'i dorëzojnë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës;

- 1.9. të marrë parasysh barazinë gjinore në rastin e emërimit të institucioneve, shkollave e rrugëve.
2. Çdo dispozitë, e cila është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë sipas këtij ligji shfuqizohet.
3. Kontratat publike si dhe çdo dispozitë në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë, e cila është e përfshirë në kontratat apo marrëveshjet individuale a kolektive, janë ose mund të shpallen të pavlefshme apo të ndryshohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi.

Ligji nr. 04/I-008 për këshillin ekonomiko-social

Neni 5

Këshilli Ekonomik-Social

1. Këshilli Ekonomik-Social (në tekstin e mëtutjeshëm “KES”), është organ i nivelit nacional, i cili udhëheq konsultimet dhe bënë propozime organeve kompetente për çështjet nga marrëdhënia e punës, mirëqenia sociale dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me politikat ekonomike në Republikën e Kosovës.
2. KES-i si organ më i lartë trepalësh është apolitik dhe funksionon si i pavarur, pa ndikim të ndonjë grupacioni apo interesi politik që vjen nga jashtë.

Neni 6

Përbërja e Këshillit Ekonomik-Social

1. KES-i përbëhet prej pesëmbëdhjetë (15) anëtarëve, të cilët në këtë organ përfaqësojnë interesat e Organizatave të punësuarve, Organizatave të punëdhënësve dhe Qeverisë.
2. KES-i përbëhet nga:
 - 2.1. pesë (5) përfaqësues të cilët caktohen nga Organizatat e të punësuarve;
 - 2.2. pesë (5) përfaqësues të cilët caktohen nga Organizatat e punëdhënësve; dhe
 - 2.3. pesë (5) përfaqësues të cilët caktohen nga Qeveria e Kosovës.
3. Përfaqësimi në KES i Organizatave të të punësuarve dhe Organizatave të punëdhënësve, përcaktohet në përputhje me kushtet dhe kriteret e parapara në nenin 7 të këtij ligji.

Kushtet dhe kriteret për përfaqësim në KES

- 1. Kushtet dhe kriteret për përfaqësimin në KES, për Organizatat e të punësuarve, janë:**

numri i përgjithshëm i anëtarëve, i vërtetuar përmes dëshmisë (deklaratave personale, librezës së anëtarësisë, etj.) dhe pagesës së anëtarësisë sindikale, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 10%, nga numri i tërësishëm i të punësuarve në Republikën e Kosovës; numri i marrëveshjeve kolektive të lidhura me ndërmarrjet apo institucionet e ndryshme; numri i degëve sindikale, të anëtarësuara në format e organizimit sindikal në nivel nacional, të cilat aplikojnë për përfaqësim në KES-ë; numri i zgjidhjes së kontesteve të punës dhe kontesteve të tjera përmes marrëveshjeve kolektive dhe ndërmjetësimit; anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare të punëtorëve.

2 . Kushtet dhe kriteret për përfaqësim në KES-ë për Organizatat e punëdhënësve janë:

- Numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të anëtarësuara, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 10% nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të regjistruara në Administratën Tatimore të Republikës së Kosovës;
- Numri i punëtorëve të punësuar në ndërmarrjet e anëtarësuara në Organizatat e punëdhënësve të cilat aplikojnë për përfaqësim në KES-ë;
- Numri i zgjidhjes së kontesteve të punës dhe kontesteve tjera, përmes marrëveshjeve kolektive dhe ndërmjetësimit;
- Numri i ndërmarrjeve dhe subjekteve të tjera ekonomike të cilat drejtpërsëdrejti ndikojnë në nxitjen e punësimit dhe zbutjen e papunësisë;
- Anëtarësimi në Organizatat ndërkombëtare të punëdhënësve.

3. Institucionet e Republikës së Kosovës, në Këshillin Ekonomik-Social, përfaqësohen nga ministrat e këtyre ministrive:

- Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Ministri i Financave;
- Ministri i Tregtisë dhe Industrisë;
- Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe
- Ministri i Shëndetësisë.

Neni 8

Funksionet e KES-it

1. Funksionet e Këshillit Ekonomik-Social janë:

- 1.1. këshillimi dhe udhëzimi i institucioneve të Republikës së Kosovës, në krijimin dhe realizimin e politikave të punës, mirëqenies sociale dhe politikave ekonomike;
- 1.2. nxitja e konsultimeve në mes palëve, si dhe nënshkrimi i kontratave dhe marrëveshjeve kolektive, në nivel nacional;
- 1.3. aktivitete të tjera të dialogimit ekonomik-social, për zhvillimin dhe avancimin e politikave të punës dhe mirëqenies sociale në Republikën e Kosovës.

Neni 9

Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e KES-it

1. KES-i me qëllim të realizimit të suksesshëm të funksioneve të tij, është përgjegjës dhe kompetent, për:
 - 1.1. krijimin, zhvillimin dhe përparimin e dialogut social në Republikën e Kosovës;
 - 1.2. nismat ligjore për nxjerrjen apo ndryshimin dhe plotësimin e akteve ligjore dhe nënligjore nga fusha e punës dhe punësimit, mbrojtjes sociale dhe politikave ekonomike në përgjithësi;
 - 1.3. shqyrtimin dhe vlerësimin e politikave sociale si dhe ndërmarrjen e masave për krijimin e qëndrueshmërisë sociale në Republikën e Kosovës;
 - 1.4. nxitjen e ideve për zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve sociale në Kosovë;
 - 1.5. politikatat e nxitjes së punësimit, zbutjen e papunësisë, konkurrencën, produktivitetin e punës, çmimet, pagat dhe pagën minimale të të punësuarave në Republikën e Kosovës;
 - 1.6. shqyrtimin e projektligjeve dhe akteve nënligjore nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes sociale, me qëllim të ofrimit të rekomandimeve për Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës;
 - 1.7. sigurimin e vlerësimeve dhe opinioneve për organet përgjegjëse lidhur me zbatimin e legjislacionit primar dhe sekondar nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes sociale;
 - 1.8. vlerësimin e funksionimit të këshillave të punës në ndërmarrjet e sektorit privat, publik dhe format e tjera të organizimit statusor të ndërmarrjeve;
 - 1.9. ofrimin dhe sigurimin e rekomandimeve për parandalimin dhe eliminimin e tregut informal të punës në Republikën e Kosovës;
 - 1.10. si dhe për çështje të tjera të cilat mund të zgjidhen përmes dialogut socio-ekonomik.

Neni 12

Komisionet profesionale trepalëshe

1. Në kuadër të KES-it, themelohen dhe funksionojnë këto komisione të përhershme profesionale trepalëshe:
 - 1.1. Komisioni për legjislacion;
 - 1.2. Komisioni për punësim dhe aftësim profesional;
 - 1.3. Komisioni për paga, çmime dhe pensione;
 - 1.4. Komisioni për mbrojtjen shëndetësore, të ambientit dhe sigurisë në punë për të punësuarit;
 - 1.5. Komisioni për financa, ekonomi dhe privatizim;
 - 1.6. Komisione apo grupe punuese ad-hoc, dhe
 - 1.7. Komisione të tjera profesionale për shqyrtimin e çështjeve të cilat janë kompetencë e KES-it.

Neni 17

Marrja e vendimeve në KES

1. Vendimet e KES –it miratohen me 2/3 e votave të anëtarëve të përhershëm të KES- it.
2. Në takimet e veta KES-i mund të ftojë OJQ-ë të ndryshme dhe persona të respektuar (shkencëtarë, ekspertë, profesionistë dhe analistë), për zgjidhjen dhe vendosjen e ndonjë çështjeje të rëndësishëm, të cilët nuk kanë të drejtë vote.
3. Të gjithë anëtarët e përfaqësuar në KES-ë kanë të drejtën e një vote.
4. Gjatë votimeve, anëtarët e përhershëm votojnë me votim të fshehtë, ndërsa kryesuesi i njofton me rezultatet e votimit në takimi.
5. Kryesuesi i KES-it, mund të vendosë që të gjithë partnerët social të votojnë me votim të hapur, kur kanë të bëjnë me çështjet procedurale dhe teknike.

Autorë: Sindikata e Policisë së Kosovës, në bashkëpunim me agjencinë e lajmeve "Ekonomia Online"

Ky manual informativ është pjesë e projektit "Ngritja e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve të punonjësve të Policisë" financohet nga "Olof Palme International Center" dhe mbështetet nga Qeveria e Suedisë.

Web: <http://spk-ks.eu>

Facebook: www.facebook.com/sindikatapk

Copyrights: SPK, Prishtinë 2019